



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0279

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Batisha Ibrahim Anëtare dhe Vedat Poterqoi Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “ANUAR” SH.P.K kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA E PRISHTINËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ofrimi i shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave loto 1 dhe loto 2 kontrate e negociuar” me nr. të prokurimit: "616-25-1133-2-1-5", me 19/05/2025, mori:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “ANUAR” SH.P.K me nr. 2025/0279, e datës 18/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ofrimi i shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave loto 1 dhe loto 2 kontrate e negociuar” me numër të prokurimit "616-25-1133-2-1-5".
- 2. Vërtetohet** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të aktiviteti të prokurimit nga AK – “KOMUNA E PRISHTINËS” lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “ANUAR” SH.P.K
5. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i deponitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 13.03.2025 “KOMUNA E PRISHTINËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ofrimi i shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave loto 1 dhe loto 2 kontrate e negociuar” me nr. të prokurimit: "616-25-1133-2-1-5",. Mërsa me datën 02.04.2025 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar PROCEDURA E NEGOCIUAR PA PUBLIKIM TE NJOFTIMIT PER KONTRATE, lloji i kontratës: SHËRBIM, vlera e parashikuar e kontratës: LLOT I-1,200.000.00EURO LLO II- 800,000.00 EURO € vlere e madhe

Me 08.04.2025, “ANUAR” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 13.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “ANUAR” SH.P.K me nr. 2025/0279 për lidhur me aktivitetin “Ofrimi i shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave loto 1 dhe loto 2 kontrate e negociuar” me nr. të prokurimit "616-25-1133-2-1-5".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “ANUAR” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

AK - KUVENDI IKOMUNES SE PRISHTINES, me datë 03.04.2025, përmes platformës elektronike e-prokurim merr vendim - 058 Njoftimi mbi vendimin e AK, që do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së, dhe rreg. Nr. 001/20222 për PP të cilat do i argumentoj dhe dëshmojmë me prova dhe fakte konkret si ne vazhdim të kësaj KpR.

Andaj duke marr për bazë dispozitat ligjore të LPP-se ne si OE palë me interesë sipas nenit 4 par. 1.26 të LPP-së, edhe për kundra faktit se ne kemi kemi arritur të plotesojm të gjitha kriteret e perzgjedhjes të përcaktuar në Ftesen për tender dhe Dosjese të tenderit, mirepo AK - Komisioni i vlerësimit - ZPP duke shkelur dispozitat ligjore të LPP, duke na eleminuar padrejtesisht, duke ne diskriminuar në detyrohemi të parashtrujm kërkesë për rishqyrtim pran

AK duke pasqyruar dhe nje here faktet dhe argumentet lidhur me shkeljet e LPP-se tek Letra standarde e elemnimit - arsytimi : Leja MJEDISORE- Leshuar nga po vet AK - Komuna e Prishtines, te cilat i kemi dorezuar ne platformen elektronike e-prokurim per kete AK me rastin e aplikimit ku argumentohet dhe konstatohet se te gjitha dokumentacionin e kerkuar per kete AP jane ne pajtim te plote me Ftesen per tender dhe Dosjese se tenderit- duke plotesuar ne teresi kriteret e perzgjedhjes dhe kriteret kryeros te dhenies se kontrates - çmimi me i ulet i pergjegjsehm.

AK me rastin e elemnimit te kompanise tone GOE per aktiviteti te prokurimit permes njoftimi 058 vendimit mbianulimin e aktivitetit te prokurimit duke na shpallur si OE TE ELEMNUAR. Ne tani po ngisim disa arsytetime KONSTATIME për këtë AP - Procedure te Prokurimit - Procedure e negociuar, si me poshtë:

Pretendimi: 1: Autoriteti kontraktues - komisioni i vleresimiti - ZPP ne komunen e Prishtines, me rastin e elemnimit permes B42 - letres standarde te elemnimit te dates; 03.04.2025, ne shkelje te nenit 59 dhe 60 te LPP-se dhe nenit 43 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP,(Krejt kjo eshte bere duke na diskriminuar duke vlerësuar plote 17 dite nga data e HAPJESE, duke kerkuar sqarime permes letres standard me date 20.03.2025 lidhur me Validitetin e LEJSE MJEDISORE, ku ne ju kemi kthyer pergjigje me date: 21.03.2025 edhe perkunder sqarimit tone I cili ka qene I sikat konkret dhe me fakte dhe argument konkret AK me date 03.04.2025 nxjer B058 njoftim mbi vendimin e AK dhe Ltreren standard te elemnimit me arsytimin lidhur me LEJE MJEDISORE duke jap arsytime te cilat jane krejt ne kundershtrim me kriteret e perzgjedhjes - kerkesat e pershtateshmerise profesionale te percaktuar ne fetsen per tender. Andaj ne vijim po theksojm arzetimin e elemnimit te lterse standarde te elemnimit te datës 03.04.2025 qwe kemi pranuar permes platformës elektornike e-prokurimit si ne vijim:

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit

Gjithashtu Komisioni I vleresimit ne raportin e tije jap arsytetime si ne vijim

Keto arsytetime te shkruar ne letrren standadre te elemnimit nga AK - ZPI> komisioni i RIVLERESIMIT nuk qendrojne per faktim se Leja MJEDISORE ne me rastin e tenderimit kemi dorezuar Lejen Mjedisore- leshuar nga vete komuna e Prishtines dhe kemi plotesuar ne teresi duke plotesuar Kërkesat mbi pershtateshmerin profesionale neni 7.1 & 7.2 te FDT-se — Ftese per tender si ne vijim.

Pra kjo deshmon se verifikimi i letrës standarde andaj kerkojm lillimishl nga ZPP ne KpR te analizoj shfletoj te gjitha dokuemntet te cilat i kemi dorezuar me rastin e tenderimit per kete AP pasi qe kemi ofruar

LEJE MJEDISORE ne pajtim te plote me kerkesen e percaktuar dosje Tenderit - Kërkesat e përshtatshmerisë profesionale, per faktin se marr baze baze kerkesen me lart ashtu sic eshte kerkuar ne dosje Tenderit askund nuk specifikon se Leja Mjedisore duhet te jete “VALIDE”

apo/ose me afat, qe do te thote se AK - KOMISIONI I VLERESIMIT - Zyrtari Pergjegjes I Prokurimit pran Komunes se Prishtine na ka ELEMINUAR ne shklje te nenit 56 par. 3 te LPP-se, per faktin se ne Dosje Tenderit nuk eshte kerkuar Leja mjedisore te jete me afat

Mirepo AK - ZPP me daten 20.03.2025 na drejtohet me letere standard per sqarime duke e ndryshuar edhe edhe kerkesen e Dosjes se Tenderit duke Shtuar Fjalen "DUHET TE JETE VALIDE" duke ndryshuar kriteret e perzgjedhjes - Kerkesat mbi pershtateshmerin profesionale gjate fazes se vleresimit, duke na diskriminuar dhe eliminuar padrejtesisht dhe ne shkleje te kritereve te perzgjedhjes ne DT

- PROVE: DT dhe letrat standard e sqarimit e dates 20.03.2025

Bazuar ne keto fakte dhe argument konkrete konstatojme se ne jemi GOE te pergjegjshem ku kemi arrit te plotesojm te gjitha Kriteret e perzgjedhjes dhe po ashtu kemi tenderuar me cmimin me te ulete te pergjegjshem, mirepo AK ne shkelje te nneit 1, 6 dhe 7 te LPP-se, ndryshon kerkesat e dosjes se Tenderit vetem per ta Eleminuar GOE pasi qe nuk mund te gjeje menyra tjera fillimisht perms letres standard kërkon sqarime duke shtuar ijalen "duhet te jete valide" me pastaj me date 28.03.2025 I drejtohet edhe zyrës Ligjore brenda Komunes se Prishtines per te prodhuar fakte dhe argument vetem e vetem ten a eleminj nga ky AP edhe perkunder se kemi plotesuar te gjitha kushtet dhe kriteret e perzgjedhjese ne DT dhe e kemi ofertuar me cmimin me te lire te Pergjegjshem

- Prove Opinonini i Zyres Ligjore -Duke marr per baze se GOE te cilet kemi tenderuar per kete AP ne kemi prezantuar - Leje mjedisor Komunal 05-352/10-81474/23 dt. 18.05.2023 me nr. 01/48, leshuar nga Sektpori I mbrojtje se mjedisit dhe efiqences se energjis i Drejtorise per Urbanizem, pas konstatimeve te leshuara nga "Mendimi i komisionit profesional" I dates 11.05.2023 me Aktvendimin 05 nr. 352/10-71474/26 te dates 15.05.2023 leshuar per OE: "Eco Clean & Energy" perfaqesuar nga Muhamet Muçiqi dhe sipas kesij aktvendim kjo leje nuk eshte percaktuar afatii vlefshmerise qe do te thote kjo leje eshte valide per faktin se ne nuk kemi pranuar asnje njoftimin mbi anulimin e kesaj leje apo per vazhdimin e saj apo diqka te tille.

Mirepo nese i Referohe mi Rregullores per ndryshim e plotesim e Rregullores per Menaxhimine e Mbeturinave nr. 01-30/01-227581/2 te dates 01.12.2023 ather eksiton nje rregullore e re qe me automatizem e rrezon rregulloren me te vjeter pra rregullorja 01-030/01 -161704/24 me 6.12.2024 e qe ka hyre ne fuqi me 1 janar 2025 konkretisht ne nenin 3 te kesaj rregullore shkruan qe afati eshte 3 vjeqar dhe prap ne e plotsojme edhe kete kriter siqe eedhe po e prezantojme nenin 3 te kesaj rregullore.

i. Paragrafi 1 i nenit 12, ndrysllohetidhë plotësohet si ne vijim:

1. Kjo leje zëvendëson licencën për menaxhimin e mbeturinave të përcaktuara në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe ka afat të vlefshmërisë për një periudhë rre (3) vjeçare siç përcaktohet në legjislacionin përkatës në fuqi për lejet mjedisore. Leja mund të vazhdohet

pas parashtfimit të kërkesës nga kompania përkatëse në Sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe enfergjisë effcifente.

PROVë: RREGULLORJA E RE 01-030/01-161704/24me 6.12.2024

Prandaj bazuar nete dispozite ligjore LEJA MJEDISORE te cilen e kemi prezantuar per kete AP ka vlefshmeri deri ne 3 (tri) vite qe do te thote se Komuna e Prishtines me rastin e vendimit per leshimit te lejese mjedisore per kompanin tone te dates 18.05.2025 Nuk ka pas rregullore apo legjislacion per rregullimin e kesaj fushe por eshte thirrur ne status, ligjin mbi Vetqeverisje locale, Ligjin mbi Mbeturina dhe vet Komuna e Prishtines nuk e percakton afatin e kesaj Leje qe do te thote se Leje e Mjedist e prezantuar nga ana jone eshte valide deri ne fund te viti 2026.

Pavaresishet kesaj validieti I lejse Mjedisore nuk ka qene kriter dhe kerkese e Dosjes se Tenderit, qe do thote se ne jemi OE I pergjegjshem dhe kemiplotesuar te gjitha kushtet dhe krteret dhe kemi tenderuar me cmimin me te ulet te pergjegjshem.

Ndersa Opinonin i Zyres Ligjore nga Komuna e Prishtines eshte I ndikuar dhe eshte ne shkleje te Rregullores per Menaxhimine e Mbeturinave nr. 01-30/01-227581/2 te dates 01.12.2023, pasi qe askund nuk thuhet se Lejet e me parshme te leshuar nga Komuna e Prishtines kane vlefshmeri per njeperiudh 1 vjecare, por thuhet kan vlefshmeri 3 vjecare, perveq keesaj nese I referohemi Ligjit mbi Proceduren Administrative neni 81 qe sqaron se Ligjet dhe rregulloret kan fuqin retroactive por hyjne ne fuqi dhe vlejen per perudhen e ardhshme. Po ashtu, kjo deshmon se Komisioni I vleresimit - ZPP kan kërkuar OPINON dhe fuqia e opinonit ligjore eshte zero sepse edhe ashtu eshte nje opinon pa asnej baze ligjore dhe krejt ipa nevojshem dhe as qe duhet te merret per baze sepse perveq qe ne kemi arrit te plotesojm kerkesat e dosjse se Tenderit gjithashtu edhe Leja e Mjedisit e leshuar nga Komuna e Prishtines te cilen e kemi bashkangjitur me rastin e tenderimit eshte me afat vlefshmerie dhe ploteson DT, Andaj kerkojm nga ZPP - Komisionii vleresimit te respektojn dispozitat ligjore te LPP-se dhe ten a rekomandojn per dhenie te kontates si tendrues me cmimim me te ulet te pergjegjshem.

AK komuna e prishtines me rastin c rekomandimit te GOE NITI - N SHPK, Clcan VWork Shines SHpk Guarde l) e Capital SHPK - Prishtin per Lot 2 Antari i grupit Niti - N Shpk e ka prezantuar Ljeen mjedisore ashtu sikurse ne pa vlefshemri te afatiti e leshuar me date 18.04.2023 vetem 3 muaj para dates se Leje Mjedisore qe kemi dorezuar ne ky Vperim I AK - ZPP - Komisionit te vleresimit eshte diskriminues dhe favorizuar ne raport me oferten tone duke demtuar buxhetin duke rekomanduar nje OE me cmimin me te lart se sa oferta jone. Ndersa Leja Mjedisore nga OE Clean Work Shines SHPKka dorzuar leje mjedisore komunale per trajtimin e mbeturinave

ndertimore qe nuk korospondon me ate qfar eshte kerkuar ne dosje te tenderit.

Andaj duke ju referuar lejes mjedisore te leshuar nga komuna e prishtines per CLEAN WORK SHINES SHPK nuk perputhet me dosjen e tenderit qe ne dosjen e tenderit kerkohet: OE-ikduhet të dorëzohet licenca për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leja mjedisore për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga ministria përkatëse) ose leje mjedisore

komunale për menaxhimin e mbeturinave (e lëshuar nga Komuna e Prishtinës). - Dëshmia e kërkuar dokumentare Licensuar për Menaxhim të Mbeturinave ose Leje Mjedisore Komunale për Menaxhim të Mbeturinave Po ashtu ka dorzuar per shpallejen e fitusit dokumentin e gjykates per aplikim ne kredi e cila nuk vlen per asgje tjeter vetem per aplikim ne kredi gje qe tregon qe GOE eshte totalisht i pa pergjegjshem dhe vërtetimi nga gjykata nuk korospodon me kerkesen e DT qe normalisht duhet te jete APLIKIM PER TENDER DHE JO APLIKIM PER KREDI.

Gjithashtu nuk poedojn Listene kontratev dhe referencave pasi qe nuk arrijn vleren per 900,000.00 euro nuk plotesojn keto kapacitet teknik dhe profesionale qe do te thote jane te papergjegjshem dhe duhet te elemniohen prandaj ne jemi dikriminuar dh eeliminuar padrejtesisht ne shkelje te dispozitave ligjore te LPP-se. Pasi qe koinpania garde de capital shpk ka referenca per pastrimin te hapsirave te brendshme dhe nuk e plotson kerkesen e FDT.

Po ashtu Ju mungojn edhe makinerit dhe paisiet i kan prezantuar pa Libreza qarkullimi valide dhe ju mungojn edhe pasha ashtu sic eshte kerkua ne Dosje tendeit iane te papergjeshem Gjithashtu nuk e plotsojne Listen e paisjeve profesionale te OE ku per kerkesen Kamionë me peshë totale <7000 ks ka dorzuar kamionet qe nuk i plotson kerkesen pasi kerkesa ka qene kamion dhe jo kamionët (01-537 - PD) po ashtu eshte kerkuar Kamion për larje me peshë bartëse > 9,000l, dhe me nivel të emetimit të gazrave Euro 3 apo teknologji më të avancuar GOE kan prezantuar Kamion me peshe bartse 6260 (01-842-UO)qe as per se afermi nuk i plotson kriteret e Dosjes se tenderit. Prishtin per Lot 1

Gjithashtu nuk poedojn Listene kontratev dhe referencave pasi qe nuk arrijn vleren per 900,000.00 euro nuk plotesojn keto kapacitet teknik dhe profesionale qe do te thote jane te papergjegjshem dhe duhet te elemniohen prandaj ne jemi dikriminuar dh eeliminuar padrejtesisht ne shkelje te dispozitave ligjore te LPP-se.

Marveshjen e konserciumit se kane sipas dispozitave qe i cakton ligji

Po ashtu Ju mungojn edhe makinerit dhe paisiet I kan prezantuar pa Libreza qarkullimi valide dhe ju mungojn edhe pasha ashtu sic eshte kerkua ne Dosje tendeit jane te papergjeshem GOE nuk e plotson Aneksin 6 ku jane lista e paisjeve profesionale

1, Kamionëme peshë totale <7000 kg - Mungojne 2 copa

3. Kamion me peshë totale 18000-27000 kg - Mungojne 4 copa

4. Kamionet special për bartjen e mbeturinave prej 1.5 në 4.5 ton, - mungon 1 cope

5. Kamion për larje me peshë bartëse > 9,000l, dhe me nivel të emetimit të gazrave Euro 3 ap teknologji më të avancuar - Mungon GOE ka prezantuar nje cistern naftes me marveshje me ELROKOS PETROL - 05-244-FE qe nuk korospodon me kerkesen ne dorjen e tenderit

Gjithashtu, ne perveq qe kemi tenderuar ne pajtim te plote me te gjitha kriteret e përzgjedhjes te përcaktuar ne dosje tenderit, po ashtu duke plotesuar Aneksin 7 me dokumentet relevante dhe

deshmi konkret, NE kemi tenderuar edhe me çmimin më të ulët të përgjegjshëm duke vendosur çmimin më të ulët se sa GOE të rekomanduar për kontratë Me këtë veprim AK - ZPP ka shkelur parimin kryesor të prokurimit "VLEREN PËR PARAT" me rastin e eliminimit të tone dhe rekomandimit të GOE për dhënie të kontratës, duke demtur Buxhetin e Komunes dhe të Republikës së Kosovës, pasi që ka rekomanduar një GOE të papërgjeshëm si dhe në të ka eliminuar NE si GOE me çmimin më të ulët të përgjegjshëm

AK me këtë veprim të ndërmarr në këtë AP të negociuar përmes platformës elektronike e-prokurim ka dëshmuar me fakte dhe prova konkrete se nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së të potencuar me lartësi pasur nevojë të sqarimeve për periudhën, pasi që edhe për kundër argumentimit të nënës KpR për periudhën vazhdon të shkellet në nenin 1, 6, 7, 24, 56, 59 dhe 60 të LPP-së si dhe në shkellet të nenit 108/A të LPP-së, konkretisht par. 8 dhe 12 duke mos dhënë asnjë provë dhe argument të bazuar në kriteret e përzgjedhjes të përcaktuar në DT, si dhe duke zvarritur shpesh gjatë vlerësimit të kësaj AP kur dihet se ka qenë procedura e negociuar dhe emergjentë këto fakte dhe prova dëshmojnë se AK sillet sikurse në procedurë të hapur dhe vonon gjatë vlerësimit dhe i cili është në shkellet flagrante të dispozitave ligjore të LPP-së, duke demtuar edhe interesin publik dhe interesin të tone material.

Gjithashtu, ja rikujtojmë AK se edhe për kundër se vete ka përcaktuar kriteret e përzgjedhjes dhe parimisht është dashur të dihet të vlerësojë tenderin në pajtim të plotë pasur nevojë për sqarime dhe OPINIONE nga një organ tjetër - zyra ligjore po ashtu është dashur të këtë parasysh nënën 134 par. 1, 2 dhe 3 të LPP-së, po ashtu Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHMË ADMINISTRATIVE lidhur me ndryshimin e legjive dhe rregulloreve për procedurë dhe Licenca që kanë marrë fuqinë juridike në kohën e leshimit sipas rregulloreve në fuqi duke marrë për bazë afatet kohore dhe jo të nënës në shkellet të nenit 56 të LPP-së.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nënën 59 LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas nenit 60 paragrafi 1 i LPP-së.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse në të ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontratë.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nënën 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i kësaj ligjeje është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktues në Kosovës.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Neni 1 të LPP-së, Neni 2 të LPP-së, Neni 6 të LPP-së, Neni 7 të LPP-së, Neni 24 te LPP-së, Neni 52 të LPP--së., Neni 56 të LPP—së, Neni 59 të LPP-së, Neni 60 par. 1.1 te LPP-së, Nenin 108/A te LPP-se, Nenin 134 te LPP-se, Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE, Neni 40.6; 40.7 dhe 40.8 të Rreg. Nr. 001/2022 per PP, Nenin 43 te Rreg. Nr. 001/2022 per PP, Nenin 45 te Rreg. Nr, 001/2022 per PP. Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe dëshmitë qe u ceken me larte, kërkojmë nga ESH dhe OSHP qe te merr: **VENDIMAPROVOHET**, - si e bazuar **Ankesa prane OSHP-së nga GOE: ANUAR SH.P.K.; MUHAMET MUCIQI; BERISHA COM SHPKANULOHET**, - njoftimi mbi vendimin e AK-se për dhenie te kontrates dhe lënda te kthehet ne **RIVLERESIM**, - Autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te bëhet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave te LPP- së. Per LOT 1 dhe PER Lot 2 Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente, dhe do te kërkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga te gjithapalët qe kane marr pjesë nekëtë aktivitet te prokurimit

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: - Lidhur me pretendimet ankimore fliimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tcn dcrues i papërgjegjshëm dhe është eleminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim: [Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshniërisë profesionale

ARSYETIM Tenderi juaj është retuzuar për këto arsye: e cekura ne vendimin e kerkese per rishqyrtim

Duke marrë parasysh faktin që pretendimet ankimorc ndërlidhen me një çështje ligjore specifike, është kërkuar nga drejtoria e Urbanizimit si dhc nga Sektori Ligjor që të konfirmojnë nëse leja mjedisore e prczantuar nga parashtruesi është me validtet ose jo.

Rrjedhimisht me datë 28.03.2025 sektori ligjor ka kthyer përgjigjen si vijon:

“Lidhur me kërkesën tuaj për informate, i jemi referuar dispozitave të Ligjit nr.04/I.-60 për mbeturina, i cili në nenin 25 përcaklon mbledhjen, grumbullimin dhe transportimn i mbeturinave, si dhe neni 34, përcakton:

Po ashtu edhe drejtoria e urbanizimit në Komunën e Prishtinës e ka mbështetur opinionin e dhënë nga sektori ligjor të elaboruar si më sipër. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorczuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eleminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të. pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.”

Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 28.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0279/25, ndërsa me datë 08.05.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0279 me rekomandimet si në vijim: ***Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.***

Lidhur me pretendimet e OE “ANUAR” SH.P.K - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0279 ka vlerësuar si në vijim:

Përshkrimi i ankesës -Ankesa është parashtruar nga Operatori Ekonomik “Anuar shpk” kundër Kuvendit të Komunës së Prishtinës për procedurën e prokurimit për “Ofrimi i shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave loto 1 dhe loto 2 kontratë e negociuar”. Ankuesit pretendojnë se janë eliminuar padrejtësisht nga gara për Leje Mjedisore Komunale dhe kundërshtojnë shpalljen e operatorit fitues, duke theksuar se OE i rekomanduar është me çmim më të lartë.

Pretendimi 1: Pretendimi i OE ankues është se janë eliminuar në mënyrë të kundërligjshme nga AK i Komunës së Prishtinës - komisioni i vlerësimit nga ky aktivitet i prokurimit pasi në GOE i kemi plotësuar kriteret e kërkuar sa i përket Leje Mjedisore Komunale për Menaxhim të Mbeturinave të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT) 7.1&7.2.

Ndërsa në mënyrë të kundërligjshme AK-ja ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e Autoritetit Kontraktues të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT). Autoriteti kontraktues - komisioni i vlerësimit - ZPP në komunën e Prishtinës, me rastin e elimitimit përmes B42 - letres standarde të eliminimit të datës; 03.04.2025, në shkëlqim të nenit 59 dhe 60 të LPP-së dhe nenit 43 të Rreg. Nr. 001/2022 për PP, (Krejt kjo është bërë duke na diskriminuar duke vlerësuar plotësisht 17 ditë nga data e HAPJESE, duke kërkuar sqarime përmes letres standarde me datë 20.03.20 lidhur me Validitetin e LEJSE MJEDISORE, ku ne ju kemi kthyer përgjigje me datë: 21.03.2017 edhe përkundër sqarimit të cilin ka qënë i saktë konkret dhe me fakte dhe argument konkret / me datë 03.04.2025 nxjerr B058 njoftim mbi vendimin e AK dhe Letrë standard të eliminimit i arsytimit lidhur me LEJE MJEDISORE duke jap arsytime të cilat janë krejt në kundërshtim me kriteret e kërkuar - kërkesat e pershtateshmerise profesionale të përcaktuara në fetsen për të Andaj në vijimpo theksojm arsytimin e eliminimit në letren standarde të eliminimit të datës 03.04.2025 kemi pranuar përmes platformes elektronike e-prokurim si në vijim:

Përgjigja në pretendime 1: Eksperti shqyrtues ka analizuar dosjen e tenderit lidhur me kriterin që është thirrur OE ankues në kriterin e kërkuar DT, në bazë të kriterit Komuna e Prishtinës ka kërkuar të ketë Leje mjedisore që OE ankues e ka ofruar Lejen Mjedisore 5-352/10-143796/23 të datës 18.08.2023 dhe 05-352/10-81474/23 të datës 18.05.2023 janë në kundërshtim me

Rregulloren e Komunale te Re 01/030/01-227581/23 qe ne baze te Rregullores se Re nenit 12 Lejet mjedisore zëvendësojnë Licencat për menaxhimin e mbeturinave qe kane qene te lëshuar me herët por ne baze te nenit 12 te kësaj rregullore vlejné vetëm një vite me mundësi vazhdimi por duhet te behet kërkesa për vazhdim nga kompanitë përkatëse.

Ne baze te dëshmimeve qe ka ofruar ne oferte GOE ankues ka Lejet Mjedisore Komunale te vitit 2023 qe nuk janë sipas Rregullores te Re qe është hyre ne fuqi ne vitin 2024 pra sipas Rregullores me nr 01/030/01-227581 /23 e qe i bije qe nuk është ne pajtueshmëri me neni 12 ku dhe komisioni i vlerësimit te ofertave ka konstatuar se është ne kundërshtim me Rregulloren Komunale 01/030/01-227581 /23 përkatësisht nenin 12, GOE i rekomanduar e ka Lejen Mjedisore sipas Rregullores se Re. Për panelin Shiko Lejen Mjedisore te OE te rekomanduar:

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), të nenit 32 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 50/06 prill 2009), nenit 11, paragrafi 1 dhe nenit 15 paragrafi 1.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01//2017 dt. 02.05.2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, nenit 25 dhe 34 të Ligjit nr. 04/L-60 për mbeturina, nenit 18 dhe 39 të Ligjit nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-60 për mbeturina, nenit 12 të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave 01-030/01-227581/23 me dt. 01.12.2023, duke vendosur sipas kërkesës 05-352/10-75223/24 dt. 11.06.2024, të kërkesit — “Clean Work Shines” sh.p.k. rnc adresë: Rr. “24 Maji”, Prishlinë, përfaqësuar nga Xhevrije Gashi nga Prishtina, për lëshimin e lejes mjedisore komunale për deponimin e përkohshëm dhe trajtimin e mbeturinave ndërtimore, Drejtoria e Urbanizmit - Sektori i Mjedisit dhe efijencës në procedurë administrative për vendosjen e çështjes paraprake, me datë 21.11.2024, merr këtë:

VENDIM PËR IEJE MJEDISORE KOMUNALE

Shiko nenin 12: Leja mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave

1.Kjo leje zëvendëson licencën për menaxhimin e mbeturinave qe me parë është lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Kjo leje lëshohet nga Komuna e Prishtinës dhe vlen për operim vetëm në temtorin e Komunes se prishtinës, si dhe ka afat të vlefshmërisë për një periudhë një (1) vjeçare. Leja mund të vazhdohet pas parashtrimit të kërkesës nga kompania përkatëse në Sektornë c mbrojtjes së mjedisit dhe energjise efijente.

2.Ne menyre qe t'i vazhdohet leja kompanisë përkatëse, e njëjta duhet të raportojë rregullisht në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë, në Sektornë për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës. si dhe në Sektornë e mbrojtjes së mjedisit dhe energjise efijente në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës.

3.Leja mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave është dokument i nevojshëm, por jo i mjaftueshmë për të operuar në Komunën e Prishtinës, pasi që për të operuar në temtorin e saj

secila kompani duhet të ketë Kontratë të lidhur me Komunën e Prishtinës në të cilën përcizohet të gjitha çështjet dhe mënyra e operimit të kompanive përkatëse të cilat pajisen me leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave. Kjo leje mund të jetë:

3.1. Leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave ndertimore;

3.2. Leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave të amviserisë;

3.3. Leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme.

3.4. Leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave specifike si vajra, goma apo të ngjashme,

3.5. Leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave në hapësira publike, të cilat hasen gjatë pastrimit të rrugëve dhe zbrazjes së shportave të xhçpit.

4. Kushtet dhe specifikat që duhet të plotësojnë kompanitë, të cilat aplikojnë për t'u pajisur me këtë leje, do të përcaktohen në aplikacionin në funksion të asaj se për cilin lloj të mbeturinave kërkohet leja.

Ne pretendimin e OE se kërkesa e DT nuk ka qenë e përcaktuar se duhet të jetë valid: Licencuar për Menaxhimin e Mbeturinave ose Leje Mjedisore Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave. Sipas ekspertit shqyrtues kërkesat e dosjes së tenderit nuk kërkohet me LPP- në të ceket "valide" kur me një kërkesë e tillë është e Rregulluar apo kërkohet me Rregulloret përkatëse që janë në fuqi. OE janë të obliguar të veprojnë dhe operojnë në territorin e Kosovës çdo herë në baze të ligjeve dhe rregulloreve që janë në fuqi dhe duhet të pajisjen me dokumente valid në përputhje me kërkesat ligjore.

OE ankues ka cekur në ankesën e tij se Leja Mjedisore e dorëzuar ka pas afat 3 vjeçar dhe është valid pasi e ka pas afat të përcaktuar, pra nuk ka afat të vlefshmërisë dhe s'kemi pranuar njoftime për anulim të Lejes mjedisore, kjo nuk qëndron pasi kur ka hyrë në fuqi Rregullorja e re nr 01/030/01-227581/23 atëherë çdo OE është i obliguar të veprojë/operoj sipas Rregullores nr 01/030/01-227581/23, një kërkesë e tillë është e specifikuar në nenin 12 të Rregullores Komunale. Sa i përket pretendimit për partnerin e rekomanduar GOE "Niti - N Shpk" se nuk e ka Leje Mjedisore Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave sipas Rregullores së re, në dosjen e tenderit nuk është kërkuar se të gjithë Grupi i OE duhet të kenë Leje Mjedisore Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave. Në përputhje me nenin 66.2 të LPP-së, si dhe nenin 26.5 dhe 26.9 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t'i specifikojë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre pretendimi nuk është i bazuar.

Shih nenin 26.5 dhe 26.9, 10 :

26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

29.9 Nëse lënda e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshinë ofrimin e shërbimeve profesionale dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën, mjafton që njëri anëtar i grupit të ketë autorizimin, apo mjafton që njëri anëtar i grupit të jetë i licencuar dhe të dorëzoj dëshminë së bashku me dokumentet tjera të tenderit të grupit të operatorëve ekonomik në mënyrë që të konsiderohet se grupi e ka përmbushë këtë kërkesë si tërësi.

29.10 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe

profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se, ku AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE.

Pretendimi 2 : AK Komuna e Prishtinës me rastin e rekomandimit të GOE Selmans Network shpk Via Shpkj_x Prishtinës për Lot 1 Gjithashtu nuk poëdojnë Listën e kontratave dhe referencave pasi që nuk arrijnë vlerën për 900.000.00 euro nuk plotësojnë kapacitetin teknik dhe profesional që do të thote janë të papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohen prandaj ne jemi diskriminuar dhe eliminuar padrejtësisht në shkelje të dispozitave ligjore të LPP-se.

Sa i përket pretendimit lidhur me referencat: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratën të ngjashme, në vlerë minimale: LOT 1-1,350,000.00 € si ekspert shqyrtues konstatojëse GOE Selmans Network shpk - Via Shpk - Prishtinë për Lot 1 ka referencat të ngjashme por AK-ja me pare ti vërtetojë se a janë në përputhje (ngjashëm) me aktivitetin e prokurimit pasi ka referencat për mirëmbajtje, renovim dhe pastrim të hapësirave, mirepo për AK-ne kanë qene të pranuar, atëher ti vërtetojë në parametra se a ka ndonjë pozicionet të njëjta/ngjashëm me aktivitetin në fjalë pasi sipas dëshmiave të dorëzuar nuk janë plotësisht të mjaftueshme. Si ekspert pasi është procedurë e negociuar pa publikim, AK-ja e kanë kualifikuar si OE që kryen shërbime të ngjashme ku janë pranuar nga AK-ja e që nuk janë plotësisht me kërkesat e DT 9.1/9.2.

Si ekspert shqyrtues i njëjti mendim vlen për referencat edhe për Grupin e OE të Lot 2 që janë të rekomanduar duke u bazuar në nenin 26.10 të RRPP.

26.10 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontrate se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se, ku AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të

plotësimi të kërkesave nga lideri i grupit të OE. Pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi 3 për pajisjet Po ashtu Ju mungojn edhe makincrit dhe paisjet I kan prezantuar pa Libreza qarkullimi valide dhe ju mungojn edhe pasha ashtu sic eshte kerkuar ne Dosje tenderit jane te papergjeshem GOE nuk e plotson Aneksin 6 ku iane lista e paisjeve profesionale

1. Kationë me peshë totale <7000 kg - Mungoine 2 copa

3. Kamionë me peshë totale 18000-27000 kg -Mungoine 4 copa

4. Kaniionet special për bartjen e mbcturinave prej 1.5 në 4.5 ton, - mungon 1 cope

5. Kamion për larje me peshë bartëse > 9,0001, dhe me nivel të emctimit të gazrave Euro 3 apo teknologji më të avaneuar-Mungon GOE ka prezantuar nje cistern naftes me marveshje me EUROKOS PETROL - 05-244-FE qe nuk korospodon me kerkesen ne dorjen e tenderit

Përgjigja ne pretendime 3 : Lidhur me pretendim e pajisjeve nuk është cekur te kërkesat tekniko profesionale 9.1/9.2 se çfarë pajisje duhet te ofrojnë OE ne këtë aktivitet te prokurimit, ne dosje është kërkuar aneksi 6 çfarë pajisje duhet te ofrohen për te realizuar kontratën qe OE te rekomanduar kane ofruar liste te pajisjeve te vulosur dhe te nënshkruar me dëshmitë përkatëse, si ekspert shqyrtues mendoj duke u bazuar ne nenin 69 te LPP-se paragrafi 1 dhe 8 kompanitë e rekomanduar për kontratë plotësojnë kërkesat e dosjen minimumin e kërkuar bashkërisht me partnerët ne konzorcium. Gjithashtu ne baze te nenit 52.7 AK ka te drejtën ti verifikoj pajisjet ne teren para rekomandimit për kontratë ose para nënshkrimit për kontratë se a janë sipas kërkesave te dosjes se tenderit dhe sipas dëshmimeve te dorëzuar ne oferte.

AK nuk ka mundur te kufizoj konkurrencën ne baze te nenit 7.3, gjithashtu AK duhet te respektoj nenin 66 paragrafin 1, mirëpo Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve, të kërkojnë lidhur me kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë qe ju kane dërguar ftesën për tender si kompani te kualifikuara. AK-ja nuk i ka cekur te kriteret e vlerësimit se pajisjet duhet te jene sipas aneksit 6 Në përputhje me paragrafin 1 të nenit 51 të LPP-së autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë kriteret e përzgjedhjes në Dosjen e tenderit që një OE duhet t'i plotësojë për tu konsideruar i kualifikuar (i përgjegjshëm).

Të gjitha kriteret e përzgjedhjes te PROCEDURA E NEGOCIUAR PA PUBLIKIM TE NJOFTIMIT PER KONTRATE duhet të kufizohen vetëm në minimumin e kriterëve te nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për t'i përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë përmes ftesës për tenderim.

Eksperti shqyrtues konstaton se as kompania ankuese Anuar shpk nuk e plotëson kriterin e pajisjeve sipas Aneksit 6 pasi ka kontrate qiraje me kompaninë “Mynyr Krasniqi B.I.” ne vitit 15.03.2021 ndërsa tenderi është i shpallur 2025 nga Komuna e Prishtinës, ne baze te kësaj pretendimi ankimor i OE ankues konsideroj se është pjesërisht i bazuar pasi si pala ankuese dhe

ato te rekomanduara nuk e plotësojnë tërësisht kërkesat e DT.

Pretendimi 4: Gjithashtu, ne perveq qe kemi tenderuar ne pajtim te plote me te gjitha kriteret e përzgjedhjes te përcaktuar ne dosje tenderit, po ashtu duke plotesuar Aneksin 7 me dokumentet relevante dhe deshmi konkret, NE kemi tenderuar edhe me çmimin mem te ulet te pergjegjshem duke vendosur çmimin me te ulcte se sa GOE te rekomanduar per kontrat Me kete veprim AK - ZPP ka shkelur parimin kryer te prokurimit “VLEREN PER PARA” me rastin e elmnimit tone dhe rekomandimin e GOE per dhenie te kontratc, duke demtur Buxhetin e Komunes dhe te Republikes se kosove, pasi qe ka rekomanduar nje GOE te papergjeshem si dhe ne ka eliminuar NE si GOE me cmiminmete ulet te pergjegjshem

Përgjigjja ne pretendim 4: Ne baze te raportit te vlerësimit si ekspert shqyrtues nuk ka mundur te konstatoj se është bere ndonjë diskriminim ndaj OE ankues Anuar shpk, gjithashtu OE ankues nuk ka ofruar ndonjë fakt/dëshmi se ku është diskriminuar si dhe qe nuk është nen përputhje me nenet 6 dhe 7 te LPP- se, ne pretendim ka cekur se është me çmim me te ulet, mirëpo nuk ne baze te Ak-se nuk është ipërgjegjshëm sipas kërkesave te përcaktuar ne dosjen e tenderi. Autoriteti kontraktues ka përgjegjësi ne baze te nenit 7 se gjate procedurës se aktivitetit të prokurimit në asnjë mënyrë nuk guxon te redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik gjate përpilimit te kritereve te vlerësimit apo gjate vlerësimit te ofertave. Ne baze te kësaj si ekspert shqyrtues pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigjja ne pretendim 5: Sa i përket pretendimit ankimor se nuk është respektuar neni 59 dhe 60 i LPP_se konstatoj si ekspert se AK i Komunës se Prishtine ka bere vlerësimin sipas nenit 59, ndërsa sa i përket nenit 60 kompania ankues është me çmim me te ulet ne vlere mirëpo sipas komisionit te vlerësimit dhe sqarimeve qe janë bere me zyrën ligjore te Komunës se Prishtine nuk është i përgjegjshme administrativisht ne baze te Rregulloren e Komunale te Re 01/030/01-227581/23 nenit 12 gjithashtu si ekspert Leja mjedisore nuk është sipas rregullores se re.

Shikoni sqarimin e zyrës Ligjore te Komunës se Prishtinës:

From: Fatos Dibra Fatos.Dibra@rks-gov.net Sent: Thursday, March 27, 2025 1:51 PM To: Jehona Mavraj <Jehona.Mavraj@rks-gov.net>; Prokurimi Prishtine prokurimi.prishtine@rks-gov.net Cc: Florent Maliqi <florent.maliqi@rks-gov.net>; Visar Shehu <visar.shehu@rks-gov.net>; Valmire Mustafa valmire.mustafa@rks-gov.net Subject: RE: Kerkese per Informate per Lejet mjedisore

Lidhur me kërkesën tuaj për informate, i jemi referuar dispozitave të Ligjit nr.04/L-60 për mbeturina, cili në nenin 25 përcakton mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin i mbeturinave, si dhe neni 34, përcakton:

1.Mbeturinat komunale duhet të mblidhen, grumbullohen trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitave tjera ligjore për rregullimin e veprimtarive komunale.

2.Komunat me akt nënligjor, përcaktojnë kushtet dhe rregullat për menaxhimin e mbeturinave nga sipërfaqet publike".

Ndërkaq, Ligji nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/ L-60 për mbeturina, me nenin 18, e ndryshon nenin 25 të Ligjit bazik, ndërkaq neni 39 i këtij Ligji përcakton:

titulli i KREUT VIII, të ligjit bazik, "Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave", zëvendësohet me titullin "Leja përkatëse Mjedisore".

2.Titulli i nenit 55, të Ugjit bazik, "Licenca për menaxhimin e mbeturinave" zëvendësohet me titullin "Leja Përkatëse Mjedisore"

3.Në nenin 55, të ligjit bazik, paragrafi 1, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: 1. Operatorëtqë menaxhojnë mbeturinat duhet të pajisen me leje përkatëse mjedisore.

AK e kuvendit Komunal të Prishtinës në rastin konkret nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të LPP, në baze të nenit 24 paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Eksperti konstaton se AK-ja ka bërë anashkalim të procedurës dhe ju ka shmangur parimeve themelore të prokurimit nën 104 në veçanti transparencës dhe konkurrencën kur ka zgjedhur procedurë të nenit 35, mirëpo edhe pas anashkalimit të procedurës se hapur AK-ja duhet t'i ketë respektuar nenin 104.paragrafi 4 dhe në baze të nenit 35 AK-ja ka për Obligim të zgjedhjes së një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi për të respektuar nenin 35.paragrafi 3.

Si ekspert shqyrtues pasi kam shqyrtuar lenden dhe të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues, ku gjatë shqyrtimit janë vërejtur shkelje të ligjit dhe proceduarave nga AK-ja dhe komisioni i vlerësimit, si dhe procedura e zgjedhur nuk është transparente dhe jo në përputhje me nenin 104, konsideroj që në baze të nenit 133 duhet të shikohen arsyet mbizotëruese dhe të vendoset pasi kontrata nuk është nënshkruar vetëm dhënia e kontratës është bërë, por përgjegjësia për pasojat e kësaj procedure janë të AK-se, si ekspert nuk ka dëshmi të reagimit të KRPP-se në e-prokurim me ndonjë reagim/opinion lidhur me procedurën e zgjedhur nga AK-ja.

E në këtë rast nuk është në kompetencën time t'i vlerësoj nenin 133 nuk mund t'i parashikoj pasojat, në këto aktivitet të prokurimit janë disa shkelje ku kam lexuar në lende dhe reagime të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Institutit Shëndetësor lidhur me mbeturinat dhe kontaminimi i tyre nëpër qytet, në kompetencën time është konstatimi i gjendjes reale, zhvillimi i kësaj procedure, e në këtë rast nëse kthehemi prap nga pika zero Licenca/ Leja mjedisore e OE ankues është prap e pa afateshme dhe i zhvillimi i një procedure të re deri të nënshkrimi i kontratës së re po merr kohë relativisht të gjatë, është konstatuar procedurë urgjente nga AK-ja e i kanë përzgjedhur si ofertues të përgjegjshëm që mund të kryejnë shërbimet dhe i kanë kualifikuar si OE të përgjegjshëm, në baze të kërkesave të dosjes së tenderit i kanë mangësitë.

Nëse do të ndërpriten këto shërbime do t'i vuajnë qytetaret pasojat, për shkak të AK-së që në rastin konkret nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të LPP-së duke shmangur nga konkurrenca por në baze të LPP-se është përgjegjësia e ZKA-së dhe ZKP-së që kanë vendosur për shmangia të procedurës.

Si rekomandim i ekspertit shqyrtues është se kam konstatuar gjendjen faktike në ekspertizë dhe kam jep mendimin tim lidhur me këtë procedurë në shqyrtimin më lart.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.-

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Ofrimi i shërbimit të grumbullimit ,transportit dhe deponimit të mbeturinave loto 1 dhe loto 2 kontrate e negociuar” me nr. të prokurimit: "616-25-1133-2-1-5",.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit

shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “ANUAR” SH.P.K. te aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ofrimi i shërbimit të grumbullimit ,transportit dhe deponimit të mbeturinave loto 1 dhe loto 2 kontrate e negociuar” me nr. të prokurimit: "616-25-1133-2-1-5", të mbetet në fuqi vendimi i AK. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e shëh si pjesërisht të bazuar, Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E PRISHTINËS” lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ofrimi i shërbimit të grumbullimit ,transportit dhe deponimit të mbeturinave loto 1 dhe loto 2 kontrate e negociuar” me nr. të prokurimit: "616-25-1133-2-1-5",, dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " ANUAR " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: